



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Kabineti i Ministrit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr. 03/2025
Datë: 13.01.2025

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 11 të Ligjit Nr.08/L -117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të neneve 9, 10 dhe 11 Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe në nenin 10 të Rregullores (QRK) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, bazuar ne raportin e Jurisë profesionale me numër të protokollit 91/2025 të datës 13.01.2025 merr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Erzë Dinarama do të përfaqësoj Republikën e Kosovës në Pavijonin e Kosovës ne Bienalen e Arkitekturës 2025 në Venecia, me projekt propozimin 'Emerging Assemblages: Navigating Shifting Ecologies "
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hajrulla Çeku
Minister

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Përfaqësuese së Pavijonit;
- Departamentit Ligjor;
- Departamentit të Kulturës;
- Arkivit të MKRS-së;



Galeria Kombëtare e Kosovës
Nacionalna Galerija Kosova
National Gallery of Kosovo

Nr. Ref. 243/2025-02


Data/Datum/Date: 10.01.2025

Nënshkrimi/Potpis/Signature: 



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports








Galeria Kombëtare e Kosovës
Nacionalna Galerija Kosova
The National Gallery of Kosova

Raport i jurisë profesionale për përzgjedhjen e projektit fitues për përfaqësimin e pavijonit të RKS-së në edicionin e 19-të të Bienales së Arkitekturës në Venecia, 2025.

Në bazë të Vendimit Nr.6542/2024, i datës 29.11.2024, të emërimit zyrtar për jurinë profesionale, nga Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sportit në Kosovë, z. Hajrulla Çeku.

Juria e përbërë nga:

1. Prof.Asst.Dr. **Rozafa Basha**, Fakulteti i Arkitekturës dhe Prorektore për ndërkombëtarizim dhe shkëmbim akademik, Universiteti i Prishtinës 
2. **Dr. Marina Otero Verzier**, Aritekte dhe hulumtuese. Ass. Prof e Dekanit në GSAPP, Columbia University, New York, 
3. **Poliksen Qorri-Dragaj**, Planifikuese urbane dhe hulumtuese, Instituti për Planifikim Urban, RPTU Kaiserslautern 
4. **Adela Demetja**, Kuratore dhe hulumtuese, Drejtuese e Tirana Art Lab 
5. **Rudina Xhaferi**, Artiste, Prof. Ass, në Fakultetin e Arteve, Universiteti i Prishtinës. 



Pas shqyrtimit të njëmbëdhjet (11) aplikimeve, juria ka përzgjedhur "Emerging Assemblages: Navigating Shifting Ecologies" nga Erzë Dinarama si propozimin fitues për Pavionin e Kosovës në Bienalen e Arkitekturës në Venecia 2025. Ky vendim u bazua në qasjen inovative të projektit, thellësinë intelektuale, përputhshmërinë me temën e Bienales dhe angazhimin e tij për të adresuar çështje kritike globale dhe lokale përmes hulumtimit arkitekturor. Projekti ka qasje eksperimentale, dinamike dhe diskursive dhe ofron një platformë për formësimin e ideve gjatë muajve të Bienales dhe ofron përfitime afatgjata për ekspertët e fushës.

Propozimi trajton njërën nga sfidat më urgjente globale – ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre në ekosisteme - përmes lentës të migrimit të specieve. Ai e pozicionon këtë fenomen si çështje hapësinore dhe ekologjike me pasojë të thella kulturore, gjeopolitike dhe mjedisore. Projekti arrin të lidhë me sukses diskutet shkencore, ekologjike dhe arkitekturore, duke e bërë atë shumë të rëndësishme për platformën e Bienales për eksplorim ndërdisiplinor.

Emerging Assemblages e kthen migrimin e specieve në një narrativë hapësinore, duke theksuar se si ndryshimet ekologjike dezorientojnë praktikën dhe marrëdhëniet e vendosura. Duke eksploruar tensionet ndërmjet modeleve shkencore parashikuese, praktikave ekologjike të lokalizuara dhe pasigurive të ndryshimeve klimatike, propozimi nxit reflektimin kritik mbi mënyrën se si shoqëritë përshtaten me një botë në ndryshim. Kjo qasje shkon përtej narrativave tradicionale mjedisore, duke e bërë atë origjinale dhe provokuese.

Projekti integron në mënyrë efektive kontekstin specifik të Kosovës, duke theksuar sfidat me të cilat përballen rajonet me të dhëna ekologjike të kufizuara dhe rëndësinë e njohurive lokale në formësimin e strategjive përshtatëse. Njëkohësisht, ai i vendos këto çështje brenda një kuadri global, duke adresuar pyetje universale rreth qeverisjes ekologjike, praktikën kulturore dhe përshtatjen hapësinore. Ky fokus i dyfishtë pasuron narrativën e pavijonit dhe zgjeron tërheqjen e tij.

Natyra ndërdisiplinore e propozimit, duke kombinuar tregimin vizual, të dhënat shkencore dhe dizajnin hapësinor gjithëpërfshirës demonstroi një kuptim të sofistikuar të ndërlidhjes mes ekologjisë, kulturës dhe arkitekturës. Mbështetja në bashkëpunimin me ekologët vendas, anëtarët e komunitetit dhe shkencëtarët në Kosovë thekson përkushtimin e tij ndaj praktikave të bazuara në kontekst.

Projekti përfshin pasigurinë jo si një kufizim, por si një hapësirë gjeneruese për praktika përshtatëse dhe përgjigje krijuese. Duke sfiduar modelet statike të ruajtjes dhe duke propozuar qasje relacionale dhe fleksibile për mirëmbajtjen ekologjike, pavijoni kontribuon në një perspektivë transformuese në diskutimet e vazhdueshme globale mbi mënyrën se si të kujdesemi për planetin dhe banorët e tij.

Propozimi bazohet në hulumtime shkencore gjithëpërfshirëse të jashtëzakonshme, përfshin kushte hapësinore specifike lokale në Kosovë dhe hap një diskurs ndërdisiplinor mbi pyetjen se si peizazhet dhe qytetet kosovare mund të reagojnë ndaj krizave të parashikueshme, siç është ndryshimi klimatik, duke u përshtatur dhe përmirësuar strategjitë ekzistuese. duke i zhvilluar ato në mënyrë të qëndrueshme dhe kështu duke forcuar qëndrueshmërinë e tyre. "Emerging Assemblages: Navigating Shifting Ecologies" karakterizohet nga një qasje e qartë dhe inovative dhe për këtë arsye është e përshtatshme për të përfaqësuar Kosovën në Bienalen e Arkitekturës 2025 në Venecia.

ENG

After reviewing 11 applications, the jury has selected "Emerging Assemblages: Navigating Shifting Ecologies" by Erzë Dinarama, as the winning proposal for the Kosovo Pavilion at the 2025 Venice Architecture Biennale. This decision was based on the project's innovative approach, intellectual depth, alignment with the Biennale's theme, and its commitment to addressing critical global and local issues through architectural inquiry. The project has an experimental, dynamic, and discursive approach and



provides a platform for shaping ideas throughout the months of the Biennale and offering long-term benefits for experts in the field.

The proposal addresses one of the most pressing global challenges—climate change and its impact on ecosystems—through the lens of species migration. It positions this phenomenon as a spatial and ecological issue with profound cultural, geopolitical, and environmental implications. The project successfully bridges scientific, ecological, and architectural discourses, making it highly relevant to the Biennale's platform for interdisciplinary exploration.

Emerging Assemblages transforms the migration of species into a spatial narrative, highlighting how ecological shifts disrupt established practices and relationships. By exploring tensions between predictive scientific models, localized ecological practices, and the uncertainties of climate change, the proposal fosters critical reflection on how societies adapt to a world in flux. This approach goes beyond conventional environmental narratives, making it both original and thought-provoking.

The project effectively integrates the specific context of Kosovo, emphasizing the challenges faced by regions with limited ecological data and the importance of local knowledge in shaping adaptive strategies. At the same time, it situates these issues within a global framework, addressing universal questions about ecological governance, cultural practices, and spatial adaptation. This dual focus enriches the pavilion's narrative and broadens its appeal.

The proposal's interdisciplinary nature, combining visual storytelling, scientific data, and immersive spatial design, demonstrates a sophisticated understanding of the interconnectedness of ecology, culture, and architecture. Its reliance on collaboration with local ecologists, community members, and scientists in Kosovo underscores its commitment to contextually grounded practices.

The project embraces uncertainty not as a limitation but as a generative space for adaptive practices and creative responses. By challenging static preservation models and proposing relational and flexible approaches to ecological maintenance, the pavilion contributes a transformative perspective to ongoing global discussions about how to care for the planet and its inhabitants.

The proposal is based on outstanding overarching scientific research, incorporates specific local spatial conditions in Kosovo and opens up an interdisciplinary discourse on the question of how Kosovar landscapes and cities can react to foreseeable crisis, such as climate change, by adapting and improving existing strategies, developing them sustainably and thereby strengthening their resilience. "Emerging Assemblages: Navigating Shifting Ecologies" is characterized by a clear and innovative approach and is therefore ideally suited to represent Kosovo at the Architecture Biennale 2025 in Venice.